

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi Fillor)
Titulli i lëndës:	Matematika 1 për Programin Fillor
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (Sem I)
Numri i orëve në javë:	3+2 (5 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	7 ECTS
Koha / lokacioni:	10-12.30
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj
Detajet kontaktuese:	ismet.temaj@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës	Në këtë kurs studentët do të marrin informacione nga logjika matematikore, teoria e bashkësive dhe e relacioneve binare, që paraqesin një kaptinë të rëndësishme të matematikës bashkëkohore. Relacionet e dinamizojnë punën me bashkësi dhe krijojnë hapësirë për zhvillimin e të menduarit “kritik” të studentëve. Nga ana tjetër, bashkësia e numrave natyrorë N , bazohet në sistemin aksiomatik të Peanos dhe arsyetohet kërkesa për zgjerimin e saj, në numra të plotë Z , racional Q dhe real R e Kompleks. Zgjidhja e shumë problemeve nga jeta e përditshme bazohet në zgjidhjen e ekuacioneve dhe inekuacioneve, përqindjeve që janë gjithashtu tema studimi të këtij kursi.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi parësor i kursit është përvetësimi i njohurive për konceptet, strukturat dhe veprimet themelore nga matematika që janë të domosdoshme për një mësimdhënë të ciklit të ultë të shkollës fillore. Qëllimi i dytë është zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të studentëve për zgjidhjen, interpretimin,

	arsyetimin dhe vlerësimin e problemeve matematikore, integrimin e matematikës me fushat tjera dhe me problemet e jetës së përditshme.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Studentët do të jenë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorin saktë simbolet e logjikës matematike dhe të konkludojnë mbi saktësinë e formulave logjike • të zbatojnë veprimet me bashkësi për të formuar bashkësi të reja • të paraqesin relacionet binare me metoda të ndryshme; • të përshkruajnë vetitë e relacioneve binare dhe të identifikojnë llojet e tyre; • të përkufizojnë pasqyrimin dhe të identifikojnë llojet e tij; • të krahasojnë bashkësitë numerike dhe të kryejnë veprimet me numra. <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi i ekuacionet dhe inekucionit dhe zbatimi i tyre ne jetën e përditshëm • Te din te zbatojnë përqindjet 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	12	12
Ushtrime në teren	2	15	30
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezantimet ,etj	3	3	9
Totali			177 orë
177: 25 ≈ 7 ECTS.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Në realizimin e temave mësimore do të shfrytëzohet		

	kjo metodologji e mësimdhënies: leksione të avancuara; diskutime; diskutime; kuize; punë e pavarur; punë në grupe; prezantime.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete: (Koll.) Testi 1 15 % (Koll.) Testi 2 25 % Provimi përfundimtar 60 % Nota përfundimtare: Pikët (%) Nota 94 -100 10 84 - 93 9 73-83 8 61-72 7 50-60 6
Literatura	
Literatura bazë:	1. Ismet Temaj Matematika elementare I (dispense) Prizren 2. S.Tahiri, S. Rudi, N. Hyseni (1986) “Matematika për studentët e grupit klasor” Prishtinë; 3. T. Wesner, H. Nustad, “Algebra with applications (WCB 1991); 4. M.Berisha, D. Kamberi, R. Gjergji, R. Zejnullahu (1990) Përmbledhje detyrash nga matematika, Prishtinë.
Literatura shtesë:	<i>Tekste shkollore (1-9) nga matematika dhe materiale nga interneti.</i>
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Kuptime hyrëse. Objektet, konstantet dhe ndryshoret. Relacionet dhe operacionet. Shprehjet dhe formulat. Logjika matematike. Kuptimi i gjykimit dhe veprimet me gjykime
Java e dytë:	Kuptimi i bashkësisë dhe elementit. Veprimet me bashkësi dhe vetitë.
Java e tretë:	Produkti kartezian i bashkësive dhe algjebra e bashkësive. Relacionet binarë dhe veprimet me relacione
Java e katërt:	Relacioni i ekuivalencës . Përkufizimi i pasqyrimt (Funksionit)
Java e pestë:	Testi 1
Java e gjashtë:	Funksioni dhe vetit e tij dhe disa funksione të veçanta
Java e shtatë:	Kuptimi i grupit. Bazat aksiomatike të aritmetikës. Bashkësia e numrave natyralë N. Zgjerimi i bashkësisë së numrave natyralë në bashkësitë e numrave te plote Z

Java e tetë:	Bashkësia e numrave racionale . Paraqitja e numrave racionale . Vetitë algjebrike e numrave racionale Q .
Java e nëntë:	Vetitë algjebrike e numrave racionale Q . Fusha e numrave real. Paraqitja e numrave real . Vetitë algjebrike te numrave real
Java e dhjetë:	Bashkësia e numrave komplekse. Rrënja algjebrike dhe numri imagjinar. Paraqitja gjeometrike e numrave komplekse Veprimet me numra komplekse
Java e njëmbëdhjetë:	Ekuacionet dhe inekuacionet lineare me një të panjohur. Zbatimi i zgjidhjes së ekuacioneve dhe inekuacioneve lineare të rendit të parë në zgjidhjen e problemeve me fjalë
Java e dymbëdhjetë:	Ekuacionet lineare me dy të panjohura .Rrafshi koordinativ kënd drejt. Grafiku i ekuacioneve lineare me dy te panjohur (funksionit lineare)
Java e trembëdhjetë:	Përpjesëtimi i drejtë dhe i zhdrejtë
Java e katërbëdhjetë:	Llogaritja e përqindjes, promilit dhe kamatës
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi 2

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë. - Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye - Studenti ka të drejtë të merr pjesë në Koll. dhe ne Provim nga lënda, Matematika 2, kur vijueshmëria është së paku 80% nga numri i përgjithshëm i orëve të planifikuara për semestër. 	